BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 79, datë 26.07.2017

PËR

"DHËNIE MENDIMI MBI NDRYSHIMIN E NIVELIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM".

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, nenit 23, pika 1, nenit 54, shkronja (k) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 22, pika 2 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" të ndryshuar; ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a"; udhëzimit nr. 3, datë 28.07.2004 i Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit "Për administrimin e ujit të pijshëm", vendimit nr. 4, datë 07.07.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha Tiranë me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë propozimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha, për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, sipas relacionit shpjegues teknико-ekonomik dhe dokumentacionit ligjor, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Bashkia Tiranë të përllogarisë dhe të vlerësoj formën e rimbursimit për çmimin e ujit të pijshëm, për pensionistët dhe familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike.

3. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha, të ndjekë hapat dhe procedurat ligjore pranë Entit Rregullator të Ujit.

4. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore"dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI